

## **ASSIST KOSOVO CENTER**

### **Shtojca 4: Statuti**

#### **Statuti i Assist Kosovo Center/ Qendra Assist Kosova**

Ky statut do të qeverisë shoqatën jofitimprurëse **Assist Kosovo Center, respektivisht Qendra Assist Kosova ASSIST**, të themeluar në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

#### **Neni 1**

#### **Emri, forma dhe adresa**

1. Organizata do të quhet **Assist Kosovo Center**.
2. Ajo mund të njihet edhe si **ASSIST**
3. Organizata është shoqatë jofitimprurëse sipas definimit të dhënë në nenin 5.2 dhe 6 të Ligjit Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.
4. Organizata nuk do të bëjë shpërndarjen e çfarëdo të ardhure neto ose fitimi si të tillë për asnjë person. Pasuria, të ardhurat dhe fitimet e organizatës do të përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të organizatës dhe nuk do të përdoren për të krijuar përfitime të veçanta individuale, qoftë në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo tërthorazi për asnjërin nga themeluesit, drejtorin, nëpunësit, ndonjë anëtar të shoqatës, ndonjë të punësuar apo donator të OJQ-së. Megjithatë pagesa e kompensimit të arsyeshëm për këta persona mund të bëhet për punën që këta persona bëjnë për këtë organizatë.
5. Çdo transaksion ndërmjet OJQ-së dhe një organizate tjetër të ndërlidhur, apo ndërmjet OJQ-së dhe anëtarëve, zyrtarëve, anëtarëve të bordit ose punonjësve të saj ndalohej, përveç, nëse organi drejtues vendos, pas hetimeve të arsyeshme, se transaksioni është në interes, i drejtë dhe i arsyeshëm për OJQ-në, dhe se OJQ-ja nuk kishte mundur të sigurojë marrëveshje më të favorshme me përpjekje të arsyeshme dhe brenda rrethanave ekzistuese.
6. Organizata mund të angazhohet në aktivitete ekonomike me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të saja jofitimprurëse, në pajtim me paragrafin 1.4 të këtij Statuti dhe nenin 4 të Ligjit për Lirim të Asociimit në OJQ 04/L-57, me kusht që të ardhurat e realizuara nëpërmjet të aktiviteteve ekonomike të shfrytëzohen ekskluzivisht për të arritur qëllimet e theksuara në këtë statut.
7. Organizata e ka zyrën e saj qendrore në **Rruga “ Ahmet Gashi” B 1 No 53 ,10000, Prishtinë**

## **Neni 2 Themeluesit**

1. Themelues të organizatës janë:

1. Visare Berisha
2. Dykë Llullaku-Balaj
3. Kimete Krasniqi-Spanca

2. Kuvendi i Anëtarëve vendos për përfaqësuesin e autorizuar të OJQ-së, znj. Visare Berisha e cila përfaqëson organizatën dhe pranon të gjitha shkresat zyrtare në emër të organizatës. Ajo është përgjegjëse për informimin e autoriteteve kompetente për çfarëdo ndryshimi në të dhënat e deklaruara në rastin e regjistrimit të organizatës.

## **Neni 3 Qëllimi**

1. Organizata është themeluar me qëllim të:

Vizioni: Puna jonë ndihmon në mbrojtjen, nxitjen dhe normalizimin e një kulture qytetare të lirisë, hapjes dhe respektit për të drejtat e të tjerëve, pa të cilën nuk mund të ketë paqe dhe liri të qëndrueshme në Kosovë, e cila bëhet një vend gjithnjë e më i begatë, duke u integruar në mënyrë progresive në bashkësinë euroatlantike me një qeverisje më efektive dhe më të përgjegjshme. Një shoqëri demokratike që respekton të drejtat e njeriut, që fuqizon kryesisht gjeneratën e të rinjve dhe grave, kundër gjuhës së urrejtjes dhe ekstremizmit, gjinore, shtetin e së drejtës dhe që punon për aspiratat e integritit të vendit përmes qëllimeve:

- a. **Mbështetjen për arritjen e barazisë gjinore** - për një shoqëri të drejtë e sociale ekonomikisht të zhvilluar me një zhvillim të qëndrueshëm, fuqizim ekonomik dhe shoqëror të grave dhe burrave nëpërmjet adresimit të pabarazive gjinore dhe promovimin e përfshirjes sociale për arritjen e barazisë gjinore si kusht i domosdoshëm drejt zhvillimit, për tolerancë zero kundër dhunës në bazë gjinore e dhunës në familje, përmes fuqizimit ekonomik të grave dhe vajzave, rritjes së ndërgjegjësimit ndaj dhunës me bazë gjinore, forcimin e mekanizmit të referimit të barazisë gjinore mbrojtje ligjore dhe administrative dhe mbështetje me shërbime për viktimat e dhunës dhe abuzuesit, si dhe mbrojtje ligjore dhe psikologjike për viktimat e dhunës dhe trafikimit.
- b. **Mbrojtja sociale. Përmirësimi dhe zhvillimi i Integritit të Pakicave Etnike.** Nxitjen e përfshirjes sociale, me fokus pakicat etnike zhvillimin e Arsimit dhe promovimi i dialogut ndërkulturor me synim që minoritetet, kryesisht gratë dhe fëmijët të gëzojnë qasje dhe përfshirje të plotë në arsim cilësor, duke mos qenë subjekt i diskriminimit dhe segregimit. Qasje të barabarta në shërbime dhe të të drejtave të barabarta për të gjithë shtetasit, forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, dhe politika anti-diskriminuese përfshirë avokimin për krijimin e

mundësive të barabarta për punësimin e romëve dhe egjiptianëve dhe grupeve tjera etnike, garantimi i një kujdesi mjekësor të qasshëm, të përballeshëm dhe të barabartë për romët dhe egjiptianët, rritja e aksesit në programet e mbrojtjes sociale për anëtarë të komuniteteve minoritare me prioritet për gratë dhe fëmijët.

- c. **Fuqizimi i Grave dhe të Rinjve:** Zhvillimi I bashkëpunimit rajonal përmes grave dhe rinisë nga vendet e rajonit dhe Kosove, nxitja dhe pjesëmarrja e tyre në proceset demokratike dhe vendim-marrese, zhvillimin e bashkëpunimit kombëtar dhe rajonal në fusha të fuqizimit politik dhe ekonomik, inovacionit, dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Rritja e përfaqësimit të të rinjve dhe grave në proceset vendim-marrese dhe përfshirja e tyre në strukturat e qeverisjes vendore. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i vazhdueshëm për pjesëmarrjen në procesin zgjedhor-elektoral. Fuqizimi i të rinjve dhe vetëpunësimi i tyre.
- d. **Zhvillimi i demokracisë dhe shtetit të së drejtës, përmirësimi i sundimit të ligjit dhe qeverisjes që përmbush nevojat e qytetarëve** - për një sistem drejtësie transparent, të pavarur dhe të përgjegjshëm, profesional dhe të besueshëm e në shërbim të qytetarëve dhe në mënyrë të veçantë, të grupeve të paavantazuara, nëpërmjet monitorimit të institucioneve të drejtësisë, avokimit, dhe edukimit publik.
- e. **Forcimi i efektivitetit dhe llogaridhënia e kuvendeve, administratave dhe proceseve zgjedhore** - të përqendrohet në përmirësimin e aftësive të organeve të zgjedhura, organeve lokale administrative dhe procedurave dhe praktikave zgjedhore, që do të përmirësojnë përgjegjshmërinë.
- f. **Partitë Politike dhe Proceset zgjedhore.** Fokusi ynë është demokratizimi i partive politike dhe forcimi i rolit dhe barazia në vendimmarrje përmes fuqizimit të të rinjve dhe gratë në partitë politike, kuvende kombëtare apo vendore.
- g. **Parandalimi i Ekstremizmit të Dhunshëm dhe gjuhës së urrejtjes në Kosovë:** Rritja e angazhimit me qytetarët, me fokus të rinjtë dhe gratë, rritja e transparencës së qeverisë dhe përmirësimi i koordinimit ndërmjet autoriteteve kombëtare dhe lokale që janë disa masa kyçe - ku edhe organizata do të punojë në forcimin e demokracisë së Kosovës.
- h. **Zhvillimi Ekonomik me fokus të veçantë gratë dhe të rinjtë.** Rritja e kapitalit njerëzor dhe rritja e bazës së aftësive profesionale është një nga fokuset e punës së organizatës.
- i. **Mbështetja për zgjidhjen e problemeve mjedisore në Kosovë** - promovimi i adaptimit dhe zbutja ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut duke theksuar Konventën e Aarhus, dhe duke vlerësuar në veçanti shëndetin e grave dhe problemet e ndotjes mjedisore. Qendra angazhohet duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet organizatave joqeveritare, qeverisë, bizneseve dhe akterëve të tjerë mjedisorë, si dhe duke mbështetur shkëmbimin e lirë të

informacionit dhe pjesëmarrjen e publikut në vendim-marrjen mjedisore.

- j. **Nxjtja e turizmit, kulturës, trashëgimisë natyrore dhe kulturore - sipërmarrja dhe inovacioni**. Zhvillimin e këtyre fushave në Kosove me fokus të vecantë tek gratë, vajzat dhe të rinjtë dhe bashkëpunimi rajonal në mes qendrës dhe shoqatave rajonale në vendet si Shqipëri, Mali i zi, Maqedoni, Kroaci, Serbi, etj.
- k. **Bashkëpunimi Rajonal dhe Evropian** për të gjitha fushat e sipërpërmendura për një shoqëri demokratike dhe të prosperuar.

2. Për t'i përmbushur qëllimet e saj, organizata do të ndërmarrë, por nuk do të kufizohet vetëm në këto lloje të aktiviteteve:

- **Fuqizimi i grave dhe i të rinjve në perspektivën politike dhe ekonomike** nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve për gratë dhe të rinjtë që ofrojnë mbështetje konkrete, duke ofruar aktivitete për ngritjen e kapaciteteve si trajnime, vizita studimore në seminare të përshtatura për publikun, ndjekje me këshillim dhe monitorim afat-gjatë për ndikimet.

- **Analiza e mbledhjes së të dhënave dhe ndërtimi i kapaciteteve - duke përfshirë** bazat, studimet dhe kërkimet tjera që ndërtohen mbi hulumtimet në tavolinë- desk research, pastaj intervistat, grupet e fokusuara, administrimin e pyetësorëve, analizat e metodologjisë së Scorecard si dhe ndërtimin e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve, punëtorive dhe konferencave për fuqizimin e grave dhe të rinjve.

- **Edukimi dhe Rritja e Ndërgjegjësimit** - sigurimi i një komponenti të fortë të arsimit të përhershëm për rritjen e ndërgjegjësimit të grave dhe të rinjve nëpërmjet ndërhyrjeve direkte në nivel qendror dhe lokal, shembuj të jetës reale dhe agjentë ndryshimi; si dhe debate dhe diskutime në televizion, radio dhe media tjera, përfshirë ato sociale.

- **Rrjetëzimi/networking** - identifikimi i të gjithë akterëve dhe faktorëve relevantë, pjesëmarrja aktive e palëve të interesuara dhe organizatave bazë gjatë hapave të zbatimit të projektit.

- **Lobimi dhe Avokimi** - zhvillimi i aktiviteteve lobuese në të gjitha fushat me interes për gratë dhe të rinjtë, që monitorojnë përdorimin e integritit gjinor në politikat për të ndërtuar terrenin për lobim për ndryshime dhe përmirësime, përpilimi i dokumenteve politike, peticioneve, letra të hapura dhe dokumente tjera, si dhe aplikim të suksesshëm duke siguruar ndikimin e veprimeve përmes përdorimit të teknikave të lobimit dhe avokimit dhe ndërtimit të konsensusit.

## **Neni 4**

### **Organet e shoqatës dhe anëtarësimi**

#### **Organet drejtuese të shoqatës janë:**

1. Kuvendi i Anëtarëve
2. Bordi Ekzekutiv
3. Drejtori Ekzekutiv

1. Anëtarësimi në organizatë është i hapur për çdo person pavarësisht prej racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. Për t'u anëtarësuar në organizatë, secili i interesuar duhet të pranojë Statutin dhe Misionin e organizatës dhe të angazhohet për përmbushjen e qëllimeve të organizatës.

2. Kuvendi i anëtarëve do të vendos nëse do të kërkohet pagesa e anëtarimit nga anëtarët. Në rast të vendosjes së pagesës së anëtarimit, Kuvendi do të vendosë për rregullat dhe procedurat e pagesës së anëtarimit, përfshirë marrjen e masave të ndryshme, deri në përjashtimin e anëtarit nga organizata në rast të mospagesës së anëtarësisë.

3. Anëtarësimi i ndonjë anëtari gjithashtu mund të përfundojë ose suspendohet me vendimin e Kuvendit të Anëtarëve në rastet në vijim: kur jep dorëheqje; kur vdes; kur kryen me dashje veprime të rënda në dëm të shoqatës ; kur me dashje nuk respekton rregullat për pjesëmarrjet në mbledhjet e shoqatës, duke kryer tre mungesa pa arsye radhazi; kur shpallet fajtor me vendim të gjykatës për kryerjen e një vepre penale. Përgjegjësia për veprimtarinë e kryer nga anëtari që largohet, është e njëjtë me atë të anëtarëve të tjerë deri në çastin e largimit. Në rast të suspendimit, kohëzgjatja e suspendimit do të përcaktohet.

4. Përfundimi ose suspendimi i anëtarimit nga Kuvendi i Anëtarëve do të vendoset me shumicë votash të anëtarëve prezent.

## **Neni 5**

### **Kuvendi i Anëtarëve**

1. Kuvendi i Anëtarëve është organi më i lartë qeverisës i organizatës. Ai përbëhet prej të gjithë anëtarëve të organizatës. **(për shoqatat e themeluara nga personat juridikë, ai përbëhet prej përfaqësuesve të deleguar nga personat juridikë/organizatat, anëtarë të shoqatës).**

2. Kuvendi i Anëtarëve ka përgjegjësinë më të lartë për politikën dhe çështjet financiare të organizatës. Në këtë kuadër, Kuvendi i Anëtarëve ka kompetencë të zgjedhë dhe të shkarkojë zyrtarët në pozita udhëheqëse të OJQ-së, të aprovojë raportet periodike financiare dhe të punës, të interpretojë dhe ndryshojë Statutin, si dhe të vendosë për bashkimin, ndarjen apo shuarjen e OJQ-së. Këto përgjegjësi nuk mund të delegohen në organet tjera më të ulta.

3. Përpos përgjegjësive të rezervuara që ka, Kuvendi i Shoqatës gjithashtu ka edhe këto përgjegjësi:

- Kuvendi i Anëtarëve është organi më i lartë vendimmarrës i shoqatës, i cili ka kompetence për çështjet si më poshtë: ***miraton apo rrezon çdo vendim me vendim dhe propozim të bordit ekzekutiv.***
- Ndryshimin e Statutit dhe të Aktit të Themelimit dhe rregulloret e brendshme;
- Transformimin, ndarjen dhe bashkimin e Qendrës me organizata të tjera jo-fitimprurëse dhe çdo vendim tjetër i kësaj natyre;
- Përcakton fushat dhe programet e veprimtarisë, kërkon dhe kontrollon rregullisht realizimin e tyre;
- Shqyrton çështjet ekonomike, financiare dhe të administrimit, miraton aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e Qendrës dhe shpenzimet e vitit.
- Nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë, organizimit dhe të strukturës së Qendrës;
- Emëron dhe shkarkon Drejtorin Ekzekutiv dhe kontrollon realizimin e detyrave dhe veprimtarinë e tij;
- Krijon komitete të posaçme si dhe organizma të tjera vendimmarrëse ose këshillimore të çdo natyre;
- Autorizon drejtpërdrejt persona për të kryer detyra të caktuara.

4. Kuvendi i Anëtarëve mund të delegojë ndonjë prej përgjegjësive të tij në organin tjetër udhëheqës të ndërmjetëm (p.sh. Bordi, Kryesia, Këshilli Drejtues) ose edhe të punësuar të organizatës, me vendimin e shumicës së anëtarëve të tij, me përjashtim të përgjegjësive të cilat nuk delegohen sipas nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe paragrafit 2 të Neni 5 të këtij Statuti.

## **Neni 6 Mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve**

1. Kuvendi i Anëtarëve do të takohet së paku një herë në vit në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore (MPV) ku shqyrtohet dhe miratohet raporti për mjetet, detyrimet, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e kaluar, si dhe plani për mjetet, e detyrimet e parapara, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e ardhshëm.

2. Kuvendi i Anëtarëve mund të takohet gjithashtu edhe në Mbledhjen e Përgjithshme të Jashtëzakonshme (MPJ) kurdoherë që kërkohet nga ***(p.sh. gjysma e anëtarëve)*** ose nga organet tjera të ndërmjetme. Një kërkesë e tillë duhet t'i drejtohet Kryesuesit të Kuvendit të Anëtarëve i cili do të lajmërojë për takimin të gjithë anëtarët, në pajtim me procedurat e përcaktuara në paragrafin vijues.

3. Lajmërimi me shkrim për MPV dhe/ose MPJ, duke përfshirë datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, së bashku me rendin e ditës për mbledhjen do t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve së paku ***(p.sh. shtatë)*** ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes.

4. Për mbajtjen e mbledhjes është e nevojshme pjesëmarrja e më shumë se gjysmës së anëtarëve. Nëse ky kuorum nuk arrihet në tentimin e parë, takimi do të shtyhet për një ditë të përcaktuar më vonë dhe lajmërimi i ri do t'u dërgohet të gjithë anëtarëve.

5. Secili anëtar i organizatës ka një votë në Kuvendin e Anëtarëve.

6. Vendimet në Kuvendin e Anëtarëve do të merren me shumicën e anëtarëve prezent.

7. Asnjë anëtar i Kuvendit të Anëtarëve nuk i lejohet të marrë pjesë në diskutime apo në marrjen e vendimeve për çështje ku ai ka interes direkt apo indirekt ekonomik. Anëtar i Kuvendit të Anëtarëve konsiderohet se ka interes ekonomik nëse ai/ajo, ose cilido anëtar i familjes së tij ka interes direkt apo indirekt ekonomik.

## Neni 7

### Organi udhëheqës i ndërmjetëm (Bordi Ekzekutiv)

1. Bazuar në përgjegjësitë e dhëna me këtë statut, organi udhëheqës i ndërmjetëm (*p.sh. Bordi Ekzekutiv, Bordi Këshillues, Këshilli*) duhet të veprojë çdo herë në pajtim me qëllimin e organizatës.

**Bordi Ekzekutiv i parë përbëhet nga minimumi tre anëtarë themelues. Anëtarët e ushtrojnë këtë post për një periudhe gjashtë (6) vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme. Ata e ndërpresin atë vetëm sipas rasteve dhe mënyrave të parashikuara në Statut ose ligj.**

- Emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Bordit Ekzekutiv bëhet nga vetë Bordi ekzistues, në çdo rast anëtar i cili është objekt votimi nuk merr pjesë në votim. **Për herën e parë emërimi i Bordit bëhet nga Themeluesit.**
- Emërimi bëhet pas votimit në të cilin Bordi duhet të shprehet pozitivisht me 2/3 e anëtarëve të pranishëm. Në rast se pas tre votimeve të njëpasnjëshme nuk arrihet shumica e kërkuar, anëtar i zgjidhet me shumicë të thjeshtë. Shkarkimi i anëtarit bëhet kur ka shkelur rëndë Statutin, Aktin e Themelimit ose rregulloren e brendshme. Anëtar i propozuar për shkarkim nuk merr pjesë në votim por ka të drejtë të mbrohet para Bordit. Për shkarkimin e anëtarit nuk nevojitet asnjë prove përveç realizimit të marrjes së vendimit konform Statutit.

2. Bordi do të ketë këto përgjegjësi:

- **Bordi Ekzekutiv** është organi i dytë më i lartë vendimmarrës i shoqatës pas Kuvendit të antarëve, i cili ka kompetence për çështjet si më poshtë:
- Ndryshimin e Statutit dhe të Aktit të Themelimit dhe rregulloret e brendshme;
- Transformimin, ndarjen dhe bashkimin e shoqatës me organizata të tjera jofitimprurëse dhe çdo vendimi tjetër të kësaj natyre;

- Përcakton fushat dhe programet e veprimtarisë, kërkon dhe kontrollon rregullisht realizimin e tyre;
- Shqyrton çështjet ekonomike, financiare dhe të administrimit, miraton aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e Shoqatës dhe shpenzimet e vitit.
- Nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë, organizimit dhe të strukturës së Shoqatës;
- Emëron dhe shkarkon Drejtorin Ekzekutiv, dhe kontrollon realizimin e detyrave dhe veprimtarinë e tij;
- Krijon komitete të posaçme si dhe organizma të tjera vendimmarrëse ose këshillimore të çdo natyre;
- Autorizon direkt persona për të kryer detyra të caktuara;
- Vendos për vete shpërndarjen e Shoqatës dhe destinacionin e pasurisë së mbetur, si dhe për çdo çështje tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.
- Te gjitha këto përgjegjësi Bordi ja kalon për miratim apo rrëzim Kuvendit të antarëve.

3. Bordi zgjedhet nga Kuvendi i Shoqatës por herën e parë nga themeluesit e shoqatës. Ata do të zgjedhen individualisht me shumicë të votave nga anëtarët e pranishëm. Mënyra e zgjedhjes dhe rregullat e punës së antarëve të Bordit, mund të rregullohen me një Rregullore të veçantë për punën e Bordit, e cila aprovohet nga Kuvendi i Anëtarëve me shumicë votash.

4. Bordi do të ketë të paktën 3 (tre) anëtarë, njëri nga të cilët zgjedhet si Kryesues i Bordit.

5. Anëtarët e Bordit ***mund*** të zgjedhen për mandate të njëpasnjëshme.

6. Anëtarët e Bordit mund të shkarkohen para përfundimit të mandatit me shumicë votash të Kuvendit të Shoqatës.

Anëtari i Bordit ndryshohet në raste specifike si:

- a) Kur jep dorëheqje;
  - b) Kur vdes;
  - c) Kur kryen me dashje veprime të rënda në dëm të Qendrës;
  - d) Kur nuk respekton me dashje rregullat për pjesëmarrjet në mbledhjet e Bordit, duke kryer tre mungesa pa arsye radhazi;
  - e) Kur shpallet fajtor me vendim të gjykatës për kryerjen e një vepre penale.
- Përgjegjësia për veprimtarinë e kryer nga anëtari që largohet është e njëjtë me atë të antarëve të tjerë deri në çastin e largimit.

7. Mandati i anëtarit të Bordit pushon:

Në rast të vdekjes,  
dorëheqjes ose  
shkarkimit nga Kuvendi i Anëtarëve.

8 Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit të Bordit, Kuvendi i Shoqatës duhet të zgjedh pasardhësin për të shërbyer për kohën e mbetur/me mandat të ri.



9. Vendimet në Bord merren me shumicë votash të anëtarëve prezent.

10. Bordi mund të vendosë t'i drejtohet për çfarëdo çështje Kuvendit të Anëtarëve për marrje të vendimeve.

10. Asnjë pagesë ose kompensim nuk duhet t'u bëhet anëtarëve të Bordit pa aprovimin e Kuvendit të Anëtarëve, dhe ato bëhen vetëm kur pagesa ose kompensimi është i arsyeshëm dhe bëhet për punën e kryer për organizatë.

11. Asnjë anëtar i Bordit nuk i lejohe të marrë pjesë në diskutime apo në marrjen e vendimeve për çështje ku ai/ajo ka interes direkt apo indirekt ekonomik. Anëtar i Bordit konsiderohet se ka interes ekonomik nëse ai/ajo, ose cilido anëtar i familjes së tij ka interes direkt apo indirekt ekonomik.

### **Neni 8 Zyrtarët dhe Nëpunësit**

1. Në rast nevoje, organizata punëson persona që të marrin përsipër kryerjen e detyrave ditore të organizatës. ***Drejtori Ekzekutiv** zgjedhet/emërohet nga Bordi Ekzekutiv dhe kalohet për miratim nga Kuvendi i Shoqatës.*

2. Zyrtarët duhet të punësohen në përputhje me Ligjin e Punës në Republikën e Kosovës, të gjitha të ardhurat dhe të mirat e tjera që duhet t'i paguhen Zyrtarit, si dhe obligimet dhe përkrahimin e punës dhe përgjegjësiive të Zyrtarit. Të gjitha pagesat duhet të jenë të arsyeshme dhe duhet të paguhen vetëm për punën e kryer për organizatë.

### **Neni 9 Shpërbërja e organizatës**

1. Organizata mund të shpërbëhet me vendimin e shumicës së anëtarëve të Kuvendit të Anëtarëve.

2. Kur të vendoset për shpërbërjen e organizatës, Kuvendi i Anëtarëve do të tregojë emrin e shoqatës ose fondacionit në Kosovë që do të marrë pasurinë e mbetur pasi të jenë paguar borxhet e organizatës. Shoqata(t) ose fondacioni(et) e zgjedhura duhet të kenë qëllime të njejta ose të ngjashme sikurse organizata.

### **Neni 10 Ndryshimet e statutit**

1. Statuti i tanishëm mund të ndryshohet me vendimin e dy të tretave e anëtarëve prezent të Kuvendit të Anëtarëve.

**Neni 11**  
**Periudhat e Raportimit dhe Viti Financiar**

1. Bordi dhe Zyrtarët e emëruar do të paraqesin raporte vjetore para Kuvendit të Anëtarëve, MPV ose kurdoherë që kërkohet nga një MPJ.
2. Viti financiar i organizatës do të përputhet me vitin kalendarik.

**Neni 12**  
**Përbërja e organeve te para drejtuese**

Anëtarët e pare te Bordit te Drejtoreve janë edhe anëtarët themelues të shoqatës:

- 1.1. Visare Berisha Shabani-Kryetare e Bordit
- 1.2 Dyke Llullaku Balaj
- 1.3 Kimete Krasniqi

Drejtor Ekzekutiv i Qendrës emërtohet Visare Berisha Shabani

Ky statut është aprovuar në **Prishtinë, Kosovë,**

Më (*datën*) **9 Nëntor 2018**

Nga anëtarët e Kuvendit :

- 1.Visare Berisha Shabani
- 2.Dyke Llullaku Balaj
- 3.Kimete Krasniqi

*Visare Berisha*

---

Nënshkruar nga Përfaqësuesi i Autorizuar